

Komisioni i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vlerësimin e Veprimtarisë Etike dhe Profesionale ka përfunduar vlerësimin e aftësive profesionale për 35% të kandidatëve për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

- *Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) miratoi gjatë muajit prill Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale të 7 prokurorëve në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme: Këto kandidatë do të nënshtrohen rivlerësimit me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK)*

Ndërkohë që Komisioni i Posaçëm i ngritur për vlerësimin e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme [ka përfunduar shqyrtimin paraprak](#) lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për [28 kandidatë](#) të cilët shprehën interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, si dhe ka miratuar [listën](#) me 24 emrat e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar garën, tashmë një nga fazat më të rëndësishme të procesit është rivlerësimi me përparësi i këtyre kandidatëve.¹

Përveç shqyrtimit dhe vlerësimit të hollësishëm që kandidatët e kualifikuar për ngritje në detyrë e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të nënshtrohen, bazuar në kriteret e përcaktuara në [Rregulloren](#) “Mbi ecurinë e procesit të emërimit të Gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, emërimi përfundimtar i tyre nuk mund të realizohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pa konfirmimin në detyrë të tyre nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Për këtë arsye, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në dy seancat e fundit plenare të muajit prill, ka përfunduar dhe miratuar me përparësi vlerësimin e aftësive profesionale për një pjesë të kandidatëve të kualifikuar për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përpara konstituimit të KLP-së, kjo kompetencë në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale është ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme.

¹ Me zgjedhjen e prokurorit Vatë Staka anëtar të KLP-së, në garë për 15 pozicionet prokurorë në Prokurorinë e Posaçme do të jenë 24 kandidatë. Lista e përditësuar do të publikohet nga KLP në faqen zyrtare të institucionit.

Ndër të tjera, deri tani, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar në seancën plenare të datës [15 prill 2019](#), Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale të prokurorëve, të cilët janë në garë për 15 pozicionet prokurorë në Prokurorinë e Posaçme si më poshtë:

1. [Doloreza Musabelliu](#)
2. [Manjola Kajani](#)
3. [Eugen Beçi](#)
4. [Elizabeta Imeraj](#)
5. [Ened Nakuçi](#)
6. [Vladimir Mara](#)

Në seancën plenare më të fundit të datës [25 prill 2019](#) është miratuar edhe Raporti për Analizimin e Aftësive Profesionale të prokurorit kandidat për në Prokurorinë e Posaçme Edvin Kondili.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas vlerësimit të kriterëve profesionale të kandidatëve në garë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme do ti kërkojë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit të përshpejtojnë procedurat e rivlerësimit për këto prokurorë.

[Aktualisht](#), nga 24 prokurorë në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, vetëm 4 prej tyre janë konfirmuar me vendim të formës së prerë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimet e 2 prej të cilëve janë ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Për të gjithë kandidatët e tjerë kanë filluar procedurat e rivlerësimit sipas shorteve respektive dhe në kuadër të rivlerësimit me përparësi, pritet përfshirja e tyre në kalendarin e seancave dëgjimore.

Anëtarët e Komisionit të KLP-së për Vlerësimin e Veprimtarisë Etike dhe Profesionale u shprehën në [mbledhjen e fundit](#) lidhur me ecurinë e përfundimit të vlerësimit të aftësive profesionale edhe për prokurorët e tjerë kandidatë në Prokurorinë e Posaçme, duke theksuar angazhimin e tyre për përshpejtimin dhe prioritarizimin e këtij procesi.

Shkolla e Magjistraturës zhvillon Fazën e I dhe të II të Konkursit të Pranimit në Formimin Fillestar për kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për këshilltarë e ndihmës ligjorë për vitin akademik 2019-2020

Në kushtet kur një pjesë e konsiderueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk janë konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke sjellë krijimin e vendeve vakante dhe nevojën për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, Shkolla e Magjistraturës vendosi gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës [29 Janar 2019](#) shpalljen e vendeve vakante për magjistratë dhe kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2019 – 2020. Ndërkohë zhvillimi i procesit të konkurrimit u përcaktua të realizohej gjatë muajit [prill 2019](#).

50 vendet vakante për magjistratë të rinj u përcaktuan në përputhje me kërkesat e [Këshillit të Lartë Gjyqësor](#) dhe [Këshillit të Lartë të Prokurorisë](#), organet kryesore qeverisëse të sistemit

gjqësor dhe të prokurorisë, të cilat përcaktuan 25 vende vakante për gjyqtarë dhe 25 vende vakante për prokurorë.

Në zbatim të këtyre procedurave, në datat [24 dhe 26 Prill 2019](#) u zhvilluan faza e I dhe II e Konkursit të Pranimi në Formimin Fillestar për kandidatët për magistratë dhe kandidatët për këshilltarë e ndihmës ligjorë për vitin akademik 2019-2020. Faza e parë ishte faza seleksionuese dhe [kandidatët e kualifikuar](#) ju nënshtruan fazës së dytë të testit profesional. Rezultatet përfundimtare pritet të shpallen gjatë ditëve në vijim.

[Siç është trajtuar edhe më herët](#), formimi i magistratëve të ardhshëm nga Shkolla e Magistraturës është konsideruar mjaft i rëndësishëm edhe në drejtim të ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë.

	Kandidatët e KUALIFIKUAR për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (KKKO)		Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale	Statusi & Vendimi i KPK *
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë		Në proces rivlerësimi
2.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme		Konfirmuar
5.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Në proces rivlerësimi
6.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Në proces rivlerësimi
7.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Konfirmuar/ANKIMUAR
8.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
9.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda		Konfirmuar/ANKIMUAR
10.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
11.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Konfirmuar
12.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
13.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
14.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
15.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
16.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan		Në proces rivlerësimi
17.	Enkeleda Xhengo	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
18.	Eugen Beçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
19.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda		Në proces rivlerësimi
20.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
21.	Manjola Kajani	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
22.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë		Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
23.	Shkëlzen Cena	Prokuror/Prokuroria Dibrës		Në proces rivlerësimi
24.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi

Lista e kandidatëve të kualifikuar dhe përjashtuar për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), 5 Prill 2019: <http://klp.al/index.php/2019/04/05/vendime-date-05-04-2019/>

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 30 prill 2019